



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gramatikë e Aplikuar

Ngarkesa: 4 kredite. 40 ore seminare

Viti / Semestri : Viti I , semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: “Bachelor në Gjuhë Frënge”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike: migena.alimehmeti@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Lënda e gramatikës së aplikuar është konceptuar sipas një plani kryesisht praktik. Përdorimi i moderuar i rregullave gramatikore të gjuhës frënge, nëpërmjet ushtrimeve të ndryshme gramatikore, do t’i mundësojë studentit familjarizimin me këto rregulla dhe me vështirësitë e një gjuhe, që atij mund t’i duket e mbushur me rregulla përjashtimore.

Lënda përmban ushtrime dhe tekste të grupuara sipas tematikave të përcaktuara në program. Për çdo çështje gramatikore të pasqyruar në program, janë parashikuar afërsisht 10 deri 15 aktivitete/ushtrime.

Objektivat specifike lëndore:

Aftësitë dhe kompetencat

Synohet që studenti

- të arrijë të marrë njohuritë bazë të lëndës si dhe të përforcojë dhe thellojë rregullat gramatikore të nivelit A2- B1
- Të dallojë dhe përdorë korrektësisht nyjet
- Të zbatojë rregullat e formimit të gjinisë dhe të numrit të emrit të përgjithshëm
- Të njohë dhe përdorë si duhet mbiemrat cilësor në fjali.
- Të njohë dhe përdorë si duhet mbiemrat dhe përemrat dëftorë dhe pronorë në fjali.
- Të njohë kategorinë e përemrave dhe të përdorë saktësisht përemrat lidhor dhe llojet e tjera
- Të njohë dhe të përdori parafjalët
- Të jetë i aftë të zgjedhojë dhe përdorë saktësisht foljet e mënyrës dëftore.